

NË HAP ME

SNRF & SNK





NË HAP ME SNRF & SNK

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse, e themeluar në vitin 2001 me qëllim të zbatimit dhe promovimit të standardeve globale dhe praktikave më të mira për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, si dhe asistimin në zhvillimin ekonomik në të mirë të interesit publik.

ShKÇAK kërkon që të gjithë anëtarët e saj në mënyrë të vazhdueshme të ruajnë kompetencat e tyre profesionale. Kjo është detyrë ndaj vetes, ndaj klientëve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe ndaj vetë ShKÇAK-së. Andaj për të lehtësuar azhurnimin me më të rejat e fundit lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) ShKÇAK publikon këtë seri të *“Në hap me SNRF & SNK”*.

Ky informator është krijuar për tu përdorur nga përgatitësit, përdoruesit dhe auditorët e pasqyrave financiare të përgatitura sipas SNRF-ve.

Publikimi paraqet një përmbledhje të ndryshimeve, të cilat mund të jenë domethënëse për disa ndërmarrje, duke ndihmuar kështu ndërmarrjet të kuptojnë nëse ato do të ndikohen nga këto ndryshime, dhe të fillojnë konsideratat e tyre. Kjo do t'i ndihmojë përgatitësit e pasqyrave financiare të planifikojnë në mënyrë më efektive raportimin financiar duke tërhequr vëmendjen aty ku mund të nevojiten procese dhe sisteme të reja ose më shumë udhëzime.

I. HYRJE

Në Kosovë Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (*Ligji Nr. 06/I-032*) kërkon që Sipërmarrjet me Interes Publik (SIP) dhe Ndërmarrjet e mëdha të përgatisin pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).

Ndërmarrjet të cilat raportojnë sipas SNRF dhe SNK, përballen me një fluks të vazhdueshëm të standardeve dhe interpretimeve të reja. Ndryshimet që rezultojnë nga publikimet e standardeve dhe interpretimeve të reja variojnë nga ndryshime të rëndësishme të parimeve themelore në ndryshime të vogla nga procesi vjetor i përmirësimit të standardeve. Këto amendamente apo publikime të standardeve të reja ndikojnë në fusha të ndryshme të kontabilitetit, të tilla si njohja, matja, prezantimi dhe shpalosjet.

Më poshtë janë cekur amendamentet në standardet ekzistuese si dhe standardet e reja si dhe datat efektive të aplikimit. Vini re se shumë deklarime përmbajnë dispozita që lejojnë ndërmarrjet të adoptojnë ndryshimet në periudha më të hershme.

Kur një standard ose interpretim është lëshuar, por ende nuk është zbatuar nga një ndërmarrje, kërkohet që ndërmarrja të shpalos çdo informacion të njohur (ose të vlerësuar në mënyrë të arsyeshme) në lidhje me të kuptuarit e ndikimit të mundshëm që do të ketë publikimi i ri në pasqyrat financiare, ose të shpjegohet arsyeja për mos vlerësimin e ndikimit të mundshëm të amendamenteve në pasqyrat financiare.

II. Standardet dhe interpretimet e zbatueshme për periudhën vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020

Ndryshimet në standardet ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK/IASB) janë efektive më ose pas 1 janar 2020.

Amendamentet në standarde:

- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 - Përkufizimi i Materialit
- Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit: Përkufizimi i një biznesi
- Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit - Faza 1
- Ndryshimet në referencat e Kuadrit Konceptual në standardet e SNRF-ve
- Ndryshim në SNRF 16 Lizingu: Koncesione Lizingu të lidhura me COVID-19

III. Standardet dhe interpretimet e publikuara nga BSNK/IASB, por ende jo të zbatueshme për periudhën vjetore që fillon më 1 janar 2020 dhe përfundon më 31 dhjetor 2020

Standardet/ Amendamentet/ Interpretimet:	Data efektive (të zbatueshme për periudhat që fillojnë më apo pas)
Ndryshimet në SNRF 4 Kontratat e Sigurimit - një përjashtim i përkohshëm opsional nga zbatimi i SNRF 9 për njësitë ekonomike veprimtaria mbizotëruese e të cilave është lëshimi i kontratave brenda objektit të SNRF 4	1 Janar 2021
Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit - Faza 2	1 Janar 2021
Ndryshimet në SNK 16 Prona, Impiantet dhe Pajisjet: Të ardhurat para përdorimit të synuar	1 Janar 2022
Ndryshimet në SNK 37 Provizionet, Pasuritë dhe Detyrimet Kontigjente: Kontratat e mëdha - Kostoja e Përbushjes së Kontratës	1 Janar 2022
Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit: Referenca në Kuadrin Konceptual	1 Janar 2022
SNRF 17 Kontratat e Sigurimit	1 Janar 2023
Ndryshimet në SNK 1: Prezantimi i Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurta ose Afatgjata	1 Janar 2023
Ndryshimet në SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikës së SNRF-ve - 2: Shpalosja e Politikave të Kontabilitetit	1 Janar 2023
Ndryshimet në SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve të Kontabilitetit	1 Janar 2023
Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF 2018-2020. Ndryshimet në standardet SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41.	N/A

VËMENDJE: Ky dokument vlenë vetëm për PF të përgatitura për vitin raportues 2020.